

**DEPARTEMENT  
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**  
Abteilung Volksschule

30 nëntor 2021

Albanisch

**INFORMACION PËR PRINDËRIT**

**"Mësimi i gjuhës gjermane përpara Kopshtit" (ProjektPilot)**

---

**Një fillim i mbarë i Kopshtit (Kindergarten) për të gjithë fëmijët**

Është e rëndësishme që të gjithë fëmijët të kenë njohuritë më të mira të mundshme të gjuhës gjermane përpara fillimit të kopshtit. Njohja e mirë e gjuhës gjermane rrit suksesin e të mësuarit të fëmijëve në kopësht dhe në shkolla.

Kantoni Aargau është duke punuar me disa komuna njëkohësisht për të kryer projekte pilote për promovimin e gjermanishtes para kopshtit. Qëllimi është që fëmijët me njohuri të pamjaftueshme të gjermanishtes të marrin pjesë në një ofertë për të promovuar gjermanishten në vitin para fillimi të kopshtit. Në varësi të situatës në komunitete të ndryshme, kjo mund të jetë një grup lojrash (Spielgruppe), një qëndër e kujdesit ditor (Kita) ose, nëse është e nevojshme një familje e kujdesit ditor që flet gjermanisht.

Për informacione të mëtejshme mbi qëllimet dhe zbatimin e projektit "Promovimi i gjermanishtes përpara Kopshtit" ("Deutschförderung vor dem Kindergarten") gjendet këtu: [www.ag.ch/bks](http://www.ag.ch/bks) > über uns > Dossiers & Projekte > Deutschförderung vor dem Kindergarten.

**Pyetësori për vlerësimin e aftësive të gjuhës gjermane**

Nga të gjithë prindërit e fëmijëve që janë rreth 18 muaj para hyrjes në kopësht kërkohet nga komuna, që të plotësojnë një pyetësor. Kjo përdoret për të vlerësuar njohuritë e fëmijëve në gjuhën gjermane. Pyetësori është zhvilluar nga Universiteti Basel (Departamenti për psikologji të Zhvillimit dhe Personalitetit). Ajo gjithashtu bën dhe vlerësimin e pyetësorit.

Pyetësori shërben për të përcaktuar se cilët fëmij flasin aspak ose shume pak gjermanisht. Komunitat kontaktojnë prindërit e këtyre fëmijëve dhe i informojnë ata për mundësinë e ndjekjes së një kursi të gjuhës gjermane një vit përpara fillimit të kopshtit. Pjesëmarrja në këtë kurs është me dëshirë, por rekomandohet shumë. Kontributet e prindërve për të ndjekur një kurs të tillë do të jenë minimale. Komuna do të informojë dhe do të rregulloj për të gjitha detajet prindërit.

**Ju lutem të gjithë prindërve**

Pë suksesin e pyetësorit është e rëndësishme që **të gjithë prindërit** të plotësojnë formularin. Kjo u mundëson komunave të kenë një pamje sa më të plotë të mundshme sa sa dhe cilët fëmijë mund të përfitojnë nga mësimi i gjuhës gjermane.

Prindërve që **flasin gjermanisht** u kërkohet të plotësojnë formularin. Për fëmijët që flasin gjermanisht janë vetëm pesë pyetje për tu plotësuar.

### **Trajtimi konfidencial i informacionit**

Informacioni mbi pyetësoin e plotësuar trajtohet me kujdes dhe në përputhje me rregulloret kantonale të mbrojtjes së të dhënave.

Informacioni do të vlerësohet në mënyrë anonime nga Universiteti i Bazelit dhe do të përdoret për qëllime shkencore. Kantoni Aargau është i pajisur vetëm me vlerësime anonime për qëllime statistike dhe për vlerësimin e projektit pilot.

Komunat – ose agjensitë e kontaktuar nga to – informojnë prindërit nëse është e nevojshme kryerja e nje kursi gjermanishte. Ju mund të përdorni detajet e kontaktit të fëmijëve me nevoja të vecanta për të informuar qëndrat mbështetëse siç janë qëndrat e kujdesit ditor (Kita) dhe grupet e lojrave (Spielgruppe) në të cilat fëmijët kanë nevojë për mbështetje gjermane, ose për të zbuluar se cilët prej këtyre fëmijëve janë rregjistruar në të vërtetë për ndihme. Të gjitha informacionet nga pyetësoi mund të përdoren vetëm në kontekstin e projektit pilot dhe jo për qëllime të tjera. Pyetësoret e plotësuar do të shkatërrohen pasi të ketë përfunduar projekti pilot.

### **Informacion në rast të pyetjeve ose paqartësive**

Në cdo komunitet që ofron "Mbështetje të gjuhës gjermane para kopshtit" si pjesë e projektit pilot, ekziston një pikë kontakti ose një person kontakti ku prindërit mund të drejtohen në rast pyetjesh apo paqartësish. Informacionet për këtë person dhe informacione të tjera për projektin pilot i marrin prindërit me një letër nga komuna.